



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL

Në bazë të nenit 7, alinea 9 të Ligjit për themelimin të Agjencisë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural (“Gazeta Zyrtare” e Republikës së Maqedonisë nr. 72/2007, 5/2009, 43/2014, 193/15, 39/16 dhe 164/18), Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 0 5 / 2 0 1 8

për dorëzimin e kërkesave për shfrytëzimin të mjeteve nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018

I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është ndarja e përkrahjes financiare për masat në vijim:

Kodi i masave	Emri i masës	Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme
112	Ndihmë të bujqve të rinj për fillim të veprimtarisë bujqësore	Deri më 600.000 denarë shpenzime të pranueshme për shfrytëzues individual

II. SHFRYTËZUESIT

Të drejtë për shfrytëzimin e mjeteve kanë subjektet në vijim:

Subjektet	Masa
Ekonomi bujqësore të regjistruar në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë së ujërave, në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural	Masa 112

III. SHUMA E PËRKRAHJES FINANCIARE

Mjetet janë të dedikuara për investime për furnizim të mjeteve të reja themelore, shpenzime operative në lidhje me mjetet e furnizuara dhe shpenzimet e tjera të parapara me Programin për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018.

Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme për shfrytëzues për Masën 112 është 600.000,00 denarë. Mjetet ndahen për periudhën e realizimit të planit afarist dhe paguhet në nivel vjetor në më të shumti tre kështe. Mbështetja është e kushtëzuar me plotësim të detyrueshëm të aktiviteteve të parapara nga Plani afarist për masën 112

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIMIN E MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI DUHET TË DORËZOHET

Kërkesat dërgohen në mënyrë elektronike pas regjistrimit të realizuar në e-baranje.ipardpa.gov.mk.

Një kërkesë mund të dorëzojë një kërkesë vetëm për një masë ose mund të dorëzojë më së shumti 2 kërkesa të veçanta për masa të ndryshme duke marrë parasysh masat e tjera nga Programi për përkrahje financiare të zhvillimit rural për vitin 2018.

Kushtet të cilat duhet ti plotësojnë kërkesit e mjeteve janë të vërtetuara me:

- Programi për përkrahje financiare në zhvillim rural për vitin 2018 (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 16/18, 100/18, 127/18 dhe 172/18),
- Ligji për bujqësi dhe zhvillim rural (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 49/2010, 53/2011, 126/2012, 15/2013, 69/2013, 106/2013, 177/2014, 25/2015, 73/2015, 83/2015, 154/2015, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/2017 dhe 83/18),
- Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve për masë për zhvillim rural (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 124/2011, 80/2013, 35/15, 101/17 dhe 162/18) dhe
- Rregulloren për kushtet plotësuese më të përafërta për përkrahje nga masat për zhvillim rural, shpenzime të pranueshme dhe shuma e përkrahjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masë të veçantë (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 124/2011, 80/2013, 72/2014, 88/2015, 35/2016 dhe 59/16),

Kërkesit e përkrahjes financiare duhet të krijojnë kërkesë elektronike për përkrahje financiare me të dhëna për lokacionin e investimit, të dhëna për investimin dhe të fusin dokumentet e nevojshme në mënyrë elektronike (ofertë për investimin e propozuar dhe planin afarist të përpiluar në pajtim me formularin e paraparë “Plani Afarist për Masën 112”)

Kërkesit të cilat i kanë plotësuar kushtet për shfrytëzimin të mjeteve për masën 121 rangohen me pikë të përcaktuara në Rregulloren për kriteret më të përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve për masa për zhvillim rural (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 162/18).

- Kërkesat me numër të njëjtë të pikëve do të rangohen sipas datës dhe kohës së parashtrimit të kërkesës elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk
- Kërkesit nuk guxojnë të fillojnë me realizimin e investimit para nënshkrimit të Marrëveshjes për bashkëfinancim me Agjencinë.
- Kërkesat të cilat nuk janë parashtruar në formë elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk nuk do të merren parasysh.

V. MARRJA E FORMULAREVE DHE UDHËZIMEVE

Udhëzimi për regjistrim të kërkesve në sistemin për parashtrim të Kërkesave në mënyrë elektronike mund të merret në faqen kryesore të e-baranje.ipardpa.gov.mk. Udhëzimi për shfrytëzuesit e masës së veçantë mund të merret pas fillimit të krijimit të kërkesës për masën. Udhëzimi për shfrytëzuesit mund të merret nga ueb faqja www.ipardpa.gov.mk por mund të merren edhe drejtpërdrejtë në Agjenci çdo ditë pune prej ora 08:30 deri në ora 16:30 në adresën:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural
Bul. “3-ta Makedonska Brigada” nr. 20
(ndërtesa e Makedonija Tabak bloku C)
1000 Shkup

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesa e plotësuar në mënyrë elektronike për përkrahje financiare duhet të merret, të shtypet dhe nënshkruhet dhe së bashku me tërë dokumentacionin shoqëruet të dorëzohet deri në Agjencinë për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural në zarf të mbyllur në të cilin në pjesën e parme në këndin e epërm të majtë qëndron **Kërkesë për përkrahje financiare dhe Numri arkivor i Kërkesës (0518-12116-XXXX/1)**. Kërkesa mund të dorëzohet përmes postës ose personalisht në arkivin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për humbjen apo hapjen e parakohshme të kërkesës.

Afati përfundimtar i dorëzimit të kërkesave është **19.10.2018**.

Kërkesat e parashtruara pas afatit të paraparë nuk do të merren parasysh.

Informata më të detajuara në kontakt tel. (02) 3097-460 ose kontakt e-mail adresën: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk dhe në ueb faqen: www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për përkrahje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural, Sektori për aprovim të projekteve.

Telefon 02 3097 - 460, çdo ditë pune prej 08.30 deri në ora 16.00

E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk



AGJENCIA PËR PËRKRAHJE FINANCIARE NË BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL